



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 187212022

Nr.i fq/Bр.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 01/12/22



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 262/2018

lidhur me pengesën për qasje fizike të personave me aftësi të kufizuara në hapësirat e Administratës Pensionale të Kosovës, Zyra Regionale e Pensioneve në Prishtinë

Për:

Z. Xhelal Sveçla, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Z. Hekuran Murati, ministër
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Kopje:

Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrat

Prishtinë, 1 dhjetor 2022

I. QËLLIMI I RAPORTIT

1. Ky rapport ka dy qëllime kryesore:
 - a. të tregojë nevojën që personave pensionistë me aftësi të kufizuara t'u mundësohet qasja e papenguar në objektin dhe në ambientet e Zyrës Regionale të Administratës Pensionale në Prishtinë;
 - b. që autoritetete publike t'u vë në dukje problemet lidhur me qasjen në objektet publike të personave me aftësi të kufizuara dhe nevojën që ata t'i gjelqjnë të drejtat dhe liritë e tyre pa asnje diskriminim dhe pa asnje barrierë, por edhe që të njëjtëve t'u ofrohet mundësia e qasjes së pavarur fizike për t'i shfrytëzuar të gjitha shërbimet publike të cilat ua mundësojnë atyre ta kenë një standard të përshtatshëm jetese dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

II. BAZA LIGJORE DHE KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
3. Gjithashtu Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit përcakton se Avokati i Popullit, mes tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “*Të bëjë hetime [...] me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
 - *publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë (neni 16, paragrafi 15);*
 - *të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre (neni 18, paragrafi 1, pika 1);*
 - *të térheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë (neni 18, pika 2);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, pika 5);*
 - *t'i publikojë njofimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, pika 6);*
 - *Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoritetete të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës (neni 18, paragrafi 3).*

4. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, nen 9, thotë se Avokati i Popullit, midis të tjerash, i ka edhe kompetencat si në vijim:
- “*Të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik* (neni 9, paragrafi 2, pika 3);
 - *informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr masa për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimin* (neni 9, paragrafi 2, pika 5);
 - *ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikat e mira në promovimin e barazisë, ... dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit* (neni 9, paragrafi 2, pika 7).”

II. GJENDJA FAKTIKE

5. Zyra Regionale e Administratës Pensionale në Prishtinë më 12 shkurt 2018. ishte zhvendosur në hapësirën e re, gjegjësisht në pjesën e ndërtuesës së ish-Bankës së Lubjanës (ish-OSBE-së) në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë. Kjo ndërtësë është ndërtuar më shumë se 30 vite më parë dhe në të cilën nuk është bërë ndonjë intervenim tjetër në strukturën e saj në mënyrë që personave me aftësi të kufizuara të mund t'u sigurohej qasja e papenguar në këtë pjesë të objektit.
6. Qasja e pavarur në ambientet e zyrave regionale të Administratës Pensionale në Prishtinë për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht të atyre që janë përdorues të karrocave, është praktikisht e pamundur, sepse për ta ekziston një pengesë arkitekturore e pakapercyeshme. Ndodhet në një lartësi të caktuar, për kapërcimin e së cilës përdoren shkallët (gjashtë shkallë të larta të pjerrëta), që është e vëtmja rrugë deri te hyrja në hapësirat e punës. Kjo paraqet gjithashtu një pengesë për të moshuarit, të cilët kanë vështirësi në lëvizje.
7. Avokati i Popullit, duke e vërejtur çdo ditë të njëjtën gjendje, kishte filluar hetimin sipas detyrës zyrtare për të hetuar nëse kishim të bënim me diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar në lidhje me qasjen fizike në objektin publik ku ofrohen shërbime publike. Në përputhje me atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me kompetencat dhe me autorizimet e veta ligjore, kishte zbatuar një procedurë me qëllim që t'i përcaktonte faktet dhe rr Ethanat juridike të rëndësishme të çështjes e cila ishte në shqyrtim.
8. Më 17 gusht 2018, përfaqësueset e Avokatit të Popullit ishin takuar me drejtorin e Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, me të cilin kishin biseduar për problemin e qasjes në hapësirat e kësaj zyre për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat e moshuar. Me këtë rast, drejtori i Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës kishte deklaruar se ishte i vetëdijshëm për problemin që kishte pasuar pasi kjo zyrë ishte zhvendosur në hapësirën e re dhe se tashmë ishin ndërmarrë masa për ta zgjidhur këtë problem, në mënyrë që të mundësohej qasja e papenguar për këtë kategori qytetarësh. Ai gjithashtu në këtë takim kishte theksuar se zgjidhja e çështjes në fjalë pritej të bëhej gjatë vitit 2019. Drejtori i Administratës Pensionale të Kosovës i kishte njoftuar përfaqësuesit e Avokatit të Popullit se ishte planifikuar që deri në krijimin e kushteve për qasjen e personave me aftësi të kufizuar si dhe të të moshuarve, të cilët nuk mund të kishin qasje të papenguar në Zyrën Regionale të Pensioneve në Prishtinë, atëherë

personeli i kësaj zyre do të dilte përpara godinës dhe t'i ofronte shërbimet e nevojshme administrative për këta persona, ndërsa për personat pensionistë që ishin plotësisht të palëvizshëm dhe ardhja e të cilëve ishte e pamundur fizikisht, kishte ekipe për regjistrimin e pensionistëve, të cilët, pas marrjes së kërkesës, shkonin në terren në adresën e pensionistit dhe realizonin vizita dhe e verifikonin gjendjen. Ai kishte theksuar se problemi ishte i njohur dhe ishte dorëzuar për zgjidhje në ministrinë përkatëse dhe se pritej një zgjidhje adekuate në të ardhmen e afërt. Ai gjithashtu kishte theksuar se në degët e tjera të Administratës Pensionale në Kosovë, qasja në objektet zyrtare për këtë grup të qytetarëve ishte siguruar në mënyrë adekuate.

9. Avokati i Popullit, deri më 9 qershor 2022, kishte vazhduar ta monitoronte situatën dhe duke parë që nuk kishte lëvizje në drejtim të zgjidhjes së problemit në fjalë, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kishte kërkuar nga udhëheqësit e Departamentit për Menaxhimin e Projekteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që është kompetent për menaxhimin e objekteve të administratës publike në Republikën e Kosovës, informata nëse ishte ndërmarrë ndonjë hap apo çfarë planifikohej të ndërmerrjej për zgjidhjen e çështjes në fjalë.
10. Më 9 qershor 2022, përfaqësueset e Avokatit të Popullit kishin zhvilluar një takim me drejtuesen e Divizionit për Politika të Patundshmërive të Departamentit të Standardeve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilës ia kishte paraqitur çështjen në fjalë si dhe veprimet e deritanishme të Avokatit të Popullit për hetimin e këtij rasti. Zyrtarja përgjegjëse e ministrisë ishte përgjigjur se kjo çështje ishte në kompetencë të kësaj ministrie dhe se përgjigen për çështjen në shqyrtim do ta dërgonte me shkrim nëpërmjet postës elektronike zyrtare.
11. Më 14 qershor 2022, shefja e Divisionit për Politikat e Patundshmërive nga Departamenti i Standardeve dhe Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ) i Ministrisë së Punëve të Brendshme kishte dërguar përgjigje përmes postës elektronike ku thuhej se DSPIMNQ-ja shpreh keqardhje për personat në fjalë dhe për të gjitha kategoritë, e sidomos për personat e moshuar, të cilët duhet të përballen me këto pengesa. Më tej në përgjigje thuhej se personat në fjalë duhet të kenë qasje në objektin dhe në shërbime, mirëpo zhvillimi i procedurave, sipas DSPIMNQ-së, kishte dështuar për shkak të mbylljes gjatë pandemisë. Për më tepër, DSPIMNQ-ja kishte njofuar se ishte duke u bërë përpjekje maksimale që ky departament të zhvendoset në një hapësirë më të përshtatshme, sepse objekti ku aktualisht gjendet duhet të lirohet i téri për shkak rinovimit të përgjithshëm që do të bëhet nga fondet e IPA-së.
12. Më 22 tetor 2022, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit është takuar me drejtorin e Zyrës Regionale Pensionale në Prishtinë, që është pjesë e njësisë administrative në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, i cili me këtë rast ka theksuar se kushtet për punë në këtë zyrë janë krejtësisht të papërshtatshme, nuk ka qasje as horizontale e as vertikale për personat me aftësi të kufizuara dhe as për të personat e moshuar me vështirësi në lëvizje. Zyra për Punën e Komisionit Mjekësor ndodhet në katin e parë dhe deri te ajo qasja për kategorinë Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) është e pamundur të arrihet. Ai si drejtor i kësaj zyre vazhdimisht i ka theksuar këto probleme para ministrisë përkatëse, por deri më tani nuk është ofruar asnjë zgjidhje lidhur me këtë problem. Numri i pensionistëve që i ushtrojnë të drejtat dhe shërbimet e tyre në këtë zyrë është më i madhi në Kosovë. Ai ka theksuar se nga numri i përgjithshëm i personave që

marrin pensionin përmes kësaj zyre, rreth 7 mijë pensione u takojnë personave me aftësi të kufizuara. Në baza ditore numri i personave që kërkon shërbime është relativisht i madh.

13. Avokati i Popullit, duke e ndjekur situatën ekzistuese që nga viti 2018 e deri më sot, konstatoi se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore nga zhvendosja e Zyrës Regionale të Administratës Pensionale në Prishtinë (mbi 5 vjet) dhe ende nuk është gjetur ndonjë zgjidhje e përshtatshme për qasje të pavarur e të papenguar në këtë hapësirë për personat me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit me vështirësi në lëvizje.

IV. INSTRUMENTET RELEVANTE LIGJORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nen 3, paragrafi 2, definon: “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të tē gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të tē drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e tē drejtave dhe në pjesëmarrjen e tē gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*”

15. Neni 21 e konfirmon:

- “1. *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*
2. *Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*
3. *Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tē tjerëve. [...].*”

16. Neni 24 [Barazia para Ligjit] definon:

- “1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*”

17. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut bazohet në parimin kryesor të tē drejtave të njeriut: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrrarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.*”¹

18. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa) është dokument ligjor drejtësuar i zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 22, paragrafi 2) dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

19. Neni 14 i Konventës definon: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca,*

¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nen 7.

ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

20. Ndërsa sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës është e definuar: “*1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*” “*2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.*”
21. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 2, definon: “*Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar*” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.”
- “*Përshtatje brenda logjikës*” ka kuptimin e çdo modifikimi dhe përshtajeje të nevojshme dhe të përshtatshme duke mos imponuar një barrë disproporcionale dhe të panevojshme, kur është e nevojshme në raste të veçanta, për tu siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin apo ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut njësoj si pjesa tjetër e popullësisë.”
22. Po ashtu neni 9 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili flet për qasjen, përcakton:
- “Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Pale do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitet dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eleminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera:
- (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe fasilitete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës;
- [...]
23. Ligji nr. 04/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD), neni 1, paragrafi 1, definon: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimi në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, originës sociale apo kombëtare, [...], gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.*”
24. Neni 2, paragrafi 1, i LMD-së definon: “*Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: 1.16. çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjisacionin në fuqi.*”

25. Neni 3, paragrafi 1, i LMD-së definon: “*1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkuption se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të têrthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*” Ndërsa në paragrafin 2 shprehimisht thuhet: “*2. Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose cenoj njohjen, gjëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*”
26. Neni 4, paragrafi 1, i LMD-së i përcakton llojet e trajtimit të pabarabartë, pika 1.1: “*Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*” Kurse pika 1.8: “*Mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji [...].*”
27. Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, neni 1, paragrafi 2, ka për qëllim: “*Të sigurojë, [...] lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.*” Ndërsa nenı 3, paragrafi 28, definon: “*Infrastruktura publike – shtrirje e ndërtesave për shpërndarjen dhe mbledhjen e postës, kujdesin shëndetësor, arsimimin, administratën publike dhe shërbimeve të tjera të ngashme.*”
28. Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara parasheh mënyrën dhe sigurimin e qasjes së papenguar, të lëvizjes, të qëndrimit dhe të punës për personat me aftësi të kufizuara, parasheh kriteret për ndërtimin e objekteve të reja dhe modernizimin e atyre të vjetrave. Neni 2, pika 3, i këtij udhëzimi thotë: “*3) Pronari i objektit ndërtimor është i obliguar që t'i mirëmbajë elementet qasëse dhe nuk guxon t'i zvogëloj kushtet e përdorimit të mjeteve ndihmëse për lëvizje të PAK.*”
29. Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023 është një dokument që paraqet një udhëzues për avancimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Objektivi Strategjik 5 parasheh krijimin e kushteve të barabarta për qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuar. Ky objektiv ka për qëllim që personave me aftësi të kufizuara t'u mundësohet qasje e barabartë me të tjerët në ambientin fizik, në transport, në informatë dhe në teknologji e në sisteme informative, në lehtësira dhe në shërbime të tjera.

V. ANALIZA E GJENDJES FAKTIKE

30. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj realizimi praktik i tyre është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta u garanton të gjithëve mbrojtje të barabartë para të gjitha organeve shtetërore dhe bartësve të autoritetit publik dhe krijon detyrimin e shtetit që t'i mbrojë këto të drejta në mënyrë të barabartë për të gjithë, pa vonesa të

pajustifikuara, duke ndërmarrë dhe duke u ofruar të gjithëve masa ligjore efikase në rast të shkeljes së çdo të drejtë të garantuar.²

31. Ndalimi kushtetues i diskriminimit është shtjelluar më hollësish me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, në të cilin, në nenin 3, parashihet parimin e barazisë, që është e rregulluar në atë mënyrë që të gjithë të jenë të barabartë dhe të gjelqojnë status dhe mbrojtje të barabartë ligjore, pa marrë parasysh karakteristikat e tyre personale, kështu që secili është i obliguar që ta respektojë parimin e barazisë, gjegjësisht ndalimin e diskriminimit. Rrjetimisht, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë, së bashku me të gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës, për mbrojtjen e të drejtave të tyre njerëzore dhe për barazi para ligjit, pa asnjë dallim në kuptimin e origjinës, të seriozitetit dhe të natyrës së aftësisë së kufizuar.
32. Kushtetuta e përcakton zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare që i garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat njëkohësisht përfaqësojnë edhe një kuadër ligjor ndërkombëtar, i cili është i domosdoshëm për luftën kundër diskriminimit. Instrumentet ndërkombëtare, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të Kosovës dhe kanë përparësi, në rast konflikti, ndaj të gjitha dispozitave ligjore dhe të akteve të tjera të institucioneve publike.³
33. Në të drejtën ndërkombëtare, diskriminimi e paraqet çdo dallim, refuzim ose kufizim mbi çfarëdo baze të mbrojtur ligjërisht, duke përfshirë edhe bazën e aftësisë së kufizuar, që ka për qëllim ose efekt shkeljen ose anulimin e pranimit, të gjëzimit ose të ushtrimit në baza të barabarta të të gjitha të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në jetën politike, në fushën ekonomike, sociale, kulturore, në atë civile dhe në fusha të tjera.
34. E drejta ndërkombëtare e thotë qartë se nuk duhet të ketë një shkallë të të drejtave dhe të dinjitetit të njeriut, por barazi për të gjithë. Në përputhje me këtë: “*Gëzimi i çdo të drejtë të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në cilëndo bazë*”⁴, në mënyrë të tillë që autoritetet publike të mos e diskriminojnë askënd në kuptim të kufizimit të gjëzimit të të drejtave të dhëna ligjërisht.
35. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj parashohin që gjëzimi i të drejtave dhe i lirive të parapara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim. Neni 14 imponon detyrime pozitive ndaj shteteve që të ndërmarrin masa për ta parandaluar dhe eliminuar diskriminimin dhe kjo e përfshin edhe nevojën që autoritetet publike t'i marrin parasysh nevojat e grupeve të veçanta, në këtë rast të personave me aftësi të kufizuara.
36. Avokati i Popullit rikujton se Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton se për t'u mundësuar personave me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet t'i ndërmarrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje në mjedisin fizik, njësoj si të tjerët. Parimet bazë të kësaj Konverte janë përfshirë në Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të

² Kapitulli II i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

³ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare].

⁴ Neni 1 i Protokollit 12 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Kufizuara 2013-2023, një dokument që është udhërrëfyes për avancimin, fuqizimin dhe mbrojtjen e këtij grupei njerëzish, si qytetarë me të drejta të barabarta.

37. Avokati i Popullit thekson se të drejtat e njeriut janë një vlerë universale dhe themel i rendit tonë kushtetues, i cili garanton barazi për të gjithë. Prandaj respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut është në sferën e të gjitha autoriteteve publike, të cilat, pa përjashtim, duhet të tregojnë vullnet të mirë për ta përmirësuar gjendjen, për të siguruar realizimin progresiv të të drejtave të njoitura me dispozitat ligjore.
38. Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD), si sistem gjithëpërfshirës i mbrojtjes nga diskriminimi në Republikën e Kosovës, e përkufizon diskriminimin si: çdo dallim, përjashtim, **kufizim** ose preferencë në çfarëdo baze, që ka për qëllim ose efekt të sigurojë ose rrezikojë njojhen, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të njoitura nga Kushtetuta dhe nga ligjet e tjera të aplikueshme.
39. Avokati i Popullit thekson që LMD-ja, përveçqë e rregullon regjimin e përgjithshëm të ndalimit të diskriminimit në bazë të gjendjes shëndetësore dhe kapacitetit të kufizuar, gjithashu definon edhe një rast të veçantë të diskriminimit në lidhje me ofrimin e shërbimeve dhe përdorimin e objekteve dhe hapësirave: “*Mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji [...].*” (neni 4, pika 1.8), që në rastin konkret nënkupton drejtpërdrejt pasjen e shërbimeve dhe qasjen e papenguar në objektet për shërbime publike të kësaj kategorie personash.
40. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, ndërtesat e shërbimit publik me qasje dhe infrastrukturë të brendshme konsiderohen pa pengesa nëse ato mund të përdoren edhe nga personat me aftësi të kufizuar pa vështirësi të veçanta dhe, si rregull, pa ndihmën e të tjerëve.

VI. KONSTATIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

41. Është e pakontestueshme që personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht aftësive të tyre, kanë të drejta dhe nevoja, të cilat shteti e ka për detyrë t'i përmbushë në bazë të konvantave dhe të standardeve ndërkombëtare por edhe në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
42. Institucionet qendrore si synim kryesor të të gjitha politikave duhet ta kenë përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, përfshirë këtu edhe jetën e personave me aftësi të kufizuara, duke arritur rezultate të qëndrueshme në përfshirjen e tyre në shoqëri, si qytetarë të cilët e gëzojnë të drejtën për mundësi të barabarta dhe i gëzojnë të gjitha të drejtat.
43. Me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe me udhëzimet përkatëse administrative për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe për qasjen në objektet ndërtimore, midis të tjerash, rregullohen kushtet dhe mënyra e planifikimit hapësinor, duke siguruar lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për të gjithë qytetarët. Të gjitha objektet që janë të dedikuara për qëllime publike dhe afariste, por edhe objektet e tjera për përdorim publik, duhet të projektohen, të ndërtohen dhe të mirëmbahen në atë mënyrë që t'u mundësojnë të gjithë përdoruesve qasje, lëvizje dhe qëndrim të papenguar, përkatësisht

përdorim në përputhje me rregulloret teknike përkatëse,⁵ të cilat përfshijnë standarde që përcaktojnë masa teknike të detyrueshme dhe kushte të projektimit, të planifikimit dhe të ndërtimit, të cilat u sigurojnë lëvizje dhe qasje të papenguar personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve dhe të moshuarve.⁶

44. Edhe pse objekti ku ndodhet Zyra Regionale e Administratës Pensionale në Prishtinë është ndërtuar para më shumë se 30 vjetësh, shfrytëzuesi i objektit ka qenë i obliguar t'i ndërmerrte të gjitha masat e nevojshme në pajtim me rregulloret në fuqi për të siguruar që objekti të jetë i qasshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.
45. Avokati i Popullit vlerëson se sigurimi i qasjes në objekte dhe në shërbime paraqet parakusht themelor për jetë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara, sepse ua mundëson atyre të marrin pjesë aktive në të gjitha fushat e jetës në baza të barabarta. Në qoftë se vetëm njëri nga elementet e qasjes nuk është adekuat, një person me aftësi të kufizuara do të gjendet në situatën e të ashtuquajturës “*ndërprerje e zinxhirit të lëvizjes*”, përkatësisht do të gjendet në situatën ku nuk ka mundësi të funksionojë në mënyrë të pavarur.
46. Mosndërmarrja e veprimeve që siguron qasje fizike për të gjithë në hapësirat e Zyrës Regionale të Administratës Pensionale në Prishtinë sjell deri te pamundësia që shërbimet e Administratës Pensionale në Prishtinë të mundë t'i shfrytëzojnë në kushte të njëjtë dhe të barabarta të gjithë qytetarët.
47. Pamundësia për të hyrë në pjesën e ndërtësës ku ndodhet Zyra Regionale e Administratës Pensionale në Prishtinë ua pamundëson personave me nevoja të veçanta që në mënyrë të pavarur t'i shfrytëzojnë shërbimet e ofruara në këtë ndërtësë dhe në këtë mënyrë t'i realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligj e që **paraqet akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë**.
48. Si rezultat i asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit nxjerr konkluzioni se dështimi i autoriteteve publike për ofrimin e përshtatjeve/akomodimeve të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre të veçanta, **përbën një akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të aftësive të kufizuara**, të përcaktuar në përputhje me nenet një (1) dhe katër (4), paragrafi 1, pikat 1 dhe 8, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “[...] ka përgjegjësi të tèrheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...]”; si dhe: “*të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 18, paragrafi 1.7),


⁵ Udhëzimi administrativ MMPH – nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor.

⁶ Udhëzimi administrativ nr. 33/2007 për akses në objektet ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara.

REKOMANDON:

1. Që Ministria e Punëve të Brendshme, në koordinim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, të sigurojë qasjen e pavarur dhe të papenguar për të gjithë personat në pjesën e objektit ku ndodhet Zyra Regionale e Administratës Pensionale në Prishtinë, duke përfshire këtu edhe sigurimin e vendparkimeve për automjetet e personave me aftësi të kufizuara ose duke e zhvendosur këtë zyrë në një hapësirë tjetër të përshtatshme që i plotëson të gjitha kushtet për qasje të papenguar për personat me aftësi të kufizuar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*") dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*"), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit